

KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT “HIDROMORAVA” SH. A GJILAN

RISHIKIMI I PLANIT TË BIZNESIT PËR VITIN 2026

(me ndryshime dhe plotësime)

Qershor, 2026

PËRMBAJTJA

1. OBJEKTIVAT AFATGJATE STRATEGJIKE TË KOMPANISË	4
1.1. Projektionet / realizimi nga viti 2024, 2025 dhe parashikimi 2026	5
2. MASAT PËR REALIZIMIN E OBJEKTIVAVE.....	8
2.1. Objektiva e parë – “Sigurimi i burimeve të mjaftueshme të ujit”	8
2.2. Objektiva e dytë – “Zvogëlimi i humbjeve teknike dhe komerciale të ujit”	8
2.3. Objektiva e tretë – “Arkëtimi i borxheve”	8
2.4. Objektiva e katërt – “Rritja e shkallës së faturimit dhe arkëtimit”	9
3. TARIFAT E SHËRBIMIT	10
4. SHËRBIMET PËR KONSUMATORË.....	11
4.1. Të ardhurat nga arkëtimi dhe shpenzimet operative	12
5. PROGRAMET E REKRUTIMIT – PLOTËSIM I POZITAVE TË REJA	13
6. INVESTIMET KAPITALE.....	14
6.1. Blerja e paisjeve fazonerike	14
6.2.Furnizimi dhe Instalimi i Manometra me GPRS	14
5.3.Investime në zvogëlimin e humbjeve të ujit	15
5.4.Modifikimet ne sistemin Scada dhe ndërrimi i pajisjeve në ITU Velekincë	15
5.5.Furnizimi me makineri për divizionin e ujërave të ndotura.....	15
7. REKAPITULIMI	16

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Treguesit e Performancës	5
Tabela 2. Planifikimet sipas procesit tarifar 2026 (shprehur në '000 m3 ose '000 euro) krahasimi me vitet 2024/2025.....	5
Tabela 3. Planifikimet sipas procesit tarifar 2026-2028 (shprehur në '000 m3 ose '000 euro)	6
Tabela 4. Pasqyra e të ardhurave, planifikimi 2025/2026.....	6
Tabela 5. Performanca nëntë mujore, për vitin 2025 (shprehur në '000 m3 ose '000 euro).....	7
Tabela 6. Planifikimi i performancës operative për vitin 2026	9
Tabela 7. Tarifat	10
Tabela 8. Parashikimi i Arkëtimit	12
Tabela 9. Shpenzimet sipas kategorive për vitet 2024, 2025 dhe 2026.....	13
Tabela 10. Blerja e paisjeve fazonerike (Rishikim i vlerës).....	14
Tabela 11. Furnizimi dhe Instalimi i Manometra me GPRS (Rishikim i vlerës).....	14
Tabela 12. Investime në zvogëlimin e humbjeve të ujit (Rishikim i vlerës dhe ndarje nga projekte në kuadër të kapitullit 10.28).....	15
Tabela 13. Modifikimet ne sistemin Scada dhe ndërrimi i pajisjeve në ITU Velekincë	15
Tabela 14. Furnizimi me makineri për divizionin e ujërave të ndotura.	15
Tabela 15. Rekapitullimi i projekteve	16

1. OBJEKTIVAT AFATGJATE STRATEGJIKE TË KOMPANISË

KRU "Hidromorava" Sh.A. përfshin Qendrën Regjionale në Gjilan dhe dy njësi operative në Viti dhe Kamenicë. Kompania funksionon në përputhje me parimet e qeverisjes korporative, duke siguruar vendimmarrje dhe llogaridhënie të rregullt ndaj Bordit të Drejtorëve dhe Njësisë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë së Republikës së Kosovës. Këto struktura garantojnë mbikëqyrje dhe drejtim të vazhdueshëm të Kompanisë, duke mundësuar ofrimin e shërbimeve cilësore për konsumatorët.

Bordi i Drejtorëve, në bashkëpunim me Menaxhmentin e Ndërmarrjes, ka përcaktuar një sërë objektivash strategjike për të udhëhequr KRU "Hidromorava" Sh.A. drejt një zhvillimi të qëndrueshëm dhe të përgjegjshëm për periudhën 2026–2028. Objektivat kryesore janë si vijon:

- a. Sigurimi i burimeve të mjaftueshme të ujit në zonën e shërbimit: Kompania synon përmirësimin e kapaciteteve të furnizimit me ujë për të përmbushur nevojat në rritje të zonës së shërbimit, përmes investimeve në burime të reja dhe menaxhimit të qëndrueshëm të resurseve ekzistuese.
- b. Zvogëlimi i humbjeve teknike dhe komerciale: Përmes përmirësimit të infrastrukturës dhe zbatimit të teknologjive moderne për monitorimin e rrjedhave dhe menaxhimin e presionit, synohet reduktimi i humbjeve të ujit dhe rritja e efikasitetit operativ.
- c. Arkëtimi i borxheve të vjetra: Për përmirësimin e stabilitetit financiar, Kompania do të zbatojë strategji efektive për arkëtimin e borxheve të vjetra, përmes qasjeve proaktive dhe mjeteve të avancuara të menaxhimit të borxhit.
- d. Rritja e shkallës së faturimit dhe arkëtimin: Për sigurimin e të ardhurave të qëndrueshme dhe mbulimin e shpenzimeve operative, do të përmirësohen proceset e faturimit dhe arkëtimin, duke angazhuar staf të trajnuar dhe teknologji të avancuar.
- e. Avancimi i sistemit informativ gjeografik (GIS): Kompania do të vazhdojë përmirësimin e sistemit GIS për mbulimin e plotë të zonës së shërbimit, duke mundësuar monitorim më të detajuar dhe planifikim efektiv të aseteve. Ky proces përfshin edhe hartimin dhe implementimin e Planit të Menaxhimit të Aseteve.
- f. Mirëmbajtja e rregullt e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit: Për garantimin e cilësisë së shërbimeve, Kompania do të vazhdojë programin e mirëmbajtjes së rregullt të rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, duke përfshirë inspektime të rregullta dhe riparime të menjëhershme për shmangien e ndërprerjeve.
- g. Përputhja me rregulloret e ARRU-së: Kompania do të zbatojë plotësisht rregulloret e Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU), përfshirë Standardet Minimale të Shërbimeve, Licencimin, Kartën e Konsumatorëve dhe politikën tarifore, duke siguruar shërbime cilësore dhe në përputhje me standardet rregullatore.

h. Rritja e transparencës në raportim: Do të përmirësohet transparenca në raportimet ndaj Bordit të Drejtorëve dhe palëve të interesuara, duke siguruar të dhëna të sakta dhe të azhurnuara mbi performancën dhe projektet e Kompanisë.

i. Rritja e vetëqëndrueshmërisë financiare: Kompania do të rrisë nivelin e mbulimit të kostove operative, me qëllim forcimin e qëndrueshmërisë financiare dhe krijimin e mundësive për investime afatgjata.

j. Rritja e vlerës së aseteve për periudhën 2026–2028: Përmes investimeve nga donatorët, qeveria dhe burimet vetanake, synohet rritja e vlerës së aseteve dhe forcimi i infrastrukturës, duke ndikuar në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve.

Këto objektiva strategjike përcaktojnë një kornizë të qartë zhvillimi për KRU “Hidromorava” Sh.A., me fokus në ofrimin e shërbimeve cilësore dhe përmbushjen e nevojave të konsumatorëve.

Për realizimin e objektivave kryesore strategjike për periudhën 2026–2028, Kompania ka paraparë përmbushjen e treguesve në vijim, të përcaktuar në koordinim me ARRU.

Tabela 1. Treguesit e Performancës

Treguesit kryesor të performancës	Njësia	2024	2025	2026	2027	2028
Ujë i pafaturuar-si përqindje	%	51.92	53.54	47.10	44.60	42.60
Norma e arkëtimit - e përgjithshme	%	114.16	100.19 ¹	95.77	96.00	96.00
Norma e arkëtimit – amvisëritë	%	116.75	97.15	96.00	96.00	96.00
Norma e arkëtimit - biznese	%	97.80	98.00	100.00	100.00	100.00
Norma e arkëtimit - Institucione	%	98.00	98.00	100.00	100.00	100.00
Norma e mbulesës së punës	Numër	1.36	1.22	1.24	1.21	1.20
Përqindja e konsumatorëve me lexim	%	99.68	99.78	99.86	99.92	100.00
Staf për 1000 konsumatorë	Numër	4.42	4.46	4.36	4.46	4.60

1.1. Projektionet / realizimi nga viti 2024, 2025 dhe parashikimi 2026

Tabela 2. Planifikimet sipas procesit tarifar 2026 (shprehur në '000 m³ ose '000 euro) krahasimi me vitet 2024/2025

Nr	Treguesi	X 1000 m ³ ose X 1000 €[1]			Plani i rritjes në %
		2024	2025	2026	2026
1	Prodhimi i ujit (m ³)	9,087	9,270	9,019	-2.71%
2	Faturimi i ujit (m ³)	4,369	4,235	4,771	12.66%

¹ Shkalla e arkëtimit rezulton mbi 100% nga faturimi vjetor për shkak se gjatë vitit janë arkëtuar edhe borxhe të vjetra. Për shkak të mungesës së sistemit të përputhjes automatike të arkëtimit me faturimin e periudhës, vlera e arkëtimit për vitin mund të tejkalojë faturimin vjetor, sikurse vitin e kaluar.

3	Uji i pafaturuar (m ³)	4,718	5,034	4,248	-15.61%
4	Faturimi €	2,489	2,803	3,991	42.38%
5	Arkëtimi €	2,841	2,920	3,847	31.75%
6	Përqindja e arkëtimimit (%)	114.14	104.19	96.39	-7.49%
7	Shpenzimet (€)	2,085	2,456	3,102	26.30%
8	Nr i konsumatorëve të regjistruar (aktiv /pasiv)	43,363	46,711	48,972	4.84%
9	Konsumatorë aktiv (numër)	39,452	42,678	44,939	5.30%
10	Konsumatorë me UM (numër)	39,327	42,533	44,875	5.51%
11	Konsumatorë me UM (%)	99.68	99.66	99.86	0.20%
12	Përqindja e ujit të faturuar	48.08	45.69	52.90	15.78%
13	Përqindja e ujit i të pa faturuar (humbja)	51.92	54.31	47.10	-13.28%
14	Norma e mbulimit të punës(4/7)	1.36	1.19	1.24	4.20%

Tabela 3. Planifikimet sipas procesit tarifor 2026 – 2028 (shprehur në '000 m³ ose '000 euro)

Nr	Treguesi	X 1000 m ³ ose X 1000 €[1]		
		2026	2027	2028
1	Prodhimi i ujit (m ³)	9,019	9,178	9,577
2	Faturimi i ujit (m ³)	4,771	5,084	5,497
3	Uji i pafaturuar (m ³)	4,248	4,093	4,080
4	Faturimi €	3,991	4,224	4,490
5	Arkëtimi €	3,847	4,065	4,315
6	Përqindja e arkëtimimit (%)	96.39	96.24	96.10
7	Shpenzimet (€)	3,102	3,356	3,601
8	Nr i konsumatorëve të regjistruar (aktiv /pasiv)	48,972	51,233	53,494
9	Konsumatorë aktiv (numër)	44,939	47,200	49,461
10	Konsumatorë me UM (numër)	44,875	47,136	49,397
11	Konsumatorë me UM (%)	99.86	99.86	99.87
12	Përqindja e ujit të faturuar	52.90	55.39	57.40
13	Përqindja e ujit i të pa faturuar (humbja)	47.10	44.60	42.60
14	Norma e mbulimit të punës(4/7)	1.24	1.26	1.25

Tabela 4. Pasqyra e të ardhurave, planifikimi 2025/2026

	Realizimi i vitit 2025	Planifikimi 2026	Realizimi janar – maj 2026
Të hyrat nga faturimi	2,765,589.00	3,991,283.00	1,512,955.00
Të hyrat e tjera	77,881.00	40,000.00	5,810.00
Total të ardhurat	2,843,470.00	4,031,283.00	1,518,765.00
Kategorizimi i shpenzimeve			

Ngarkesa për shërbime ndaj ARRU, MMPH, SHUKOS	-36,261.00	-48,196.00	-18,166.00
Shpenzimet e materialit dhe të materieve të konsumueshme (analiza te ujit dhe kimikate)	-94,554.00	-95,600.00	-13,536.00
Shpenzimet e shërbimeve të kontraktuara	-60,531.00	-63,200.00	-25,300.00
Shpenzimet e energjisë	-485,000.00	-679,500.00	-237,417.00
Shpenzimet e mirëmbajtjes dhe të riparimit	-48,295.00	-42,372.00	-26,960.00
Shpenzimet e derivateve	-33,609.00	-40,000.00	-20,355.00
Shpenzimet e pagave	-1,652,343.00	-2,097,608.00	-841,986.00
Shpenzimet tjera direkte dhe indirekte	-58,391.00	-35,500.00	-19,767.00
Total shpenzimet operative	-2,468,984.00	-3,101,976.00	1,203,487.00
Shpenzimet e provizionimit (borxh i keq)	-30,834.00	-35,000.00	
Shpenzimet e zhvleresimit	-1,081,143.00	-1,290,000.00	-537,000.00
Te hyrat nga grantet	633,489.00	750,000.00	312,000.00
Total Fitimi/Humbja e vitit	-90,755.00	354,307.00	90,278.00

Tabela 5. Performanca nëntë mujore, për vitin 2025 (shprehur në "000 m3 ose "000 euro)

Nr	Performanca e KRU "Hidromorava" SH.A.- Gjilan X1000 m3 dhe X1000 €	Të realizuar në vitin 2025	Të planifikuar në vitin 2025	Realizimi i planit në vitin 2025 në %
1	Prodhimi i ujit m ³	9,270	9,770	94.89
2	Faturimi i ujit m ³	4,235	5,160	82.09
3	Uji i pafaturuar (humbja)	5,034	4,609	109.22
4	Faturimi €	2,803	3,263	85.89
5	Arkëtimi €	2,920	3,156	92.52
6	Përqindja e arkëtimit (%)	104.19	96.72	107.72
7	Shpenzimet €	2,456	2,415	101.69
8	Konsumatorëve të regjistruar (numër)	46,711	43,383	107.67
9	Konsumatorë aktivë (numër)	42,678	40,864	104.44
10	Konsumatorëve me UM (numër)	42,533	40,745	104.39
11	Përqindja e konsumatorëve me UM	99.66	99.71	99.95
12	Përqindja e ujit të faturuar	45.69	52.82	86.50
13	Përqindja e ujit të pa faturuar (humbja)	54.31	47.18	115.11
14	Norma e mbulimit të punës	1.19	1.31	90.98

2. MASAT PËR REALIZIMIN E OBJEKTIVAVE

2.1. Objektiva e parë – “Sigurimi i burimeve të mjaftueshme të ujit”

Realizimi i objektivës për sigurimin e burimeve të mjaftueshme të ujit kërkon kapacitete financiare dhe teknike që tejkalojnë mundësitë aktuale vetanake të Kompanisë. Për këtë arsye, Kompania do të orientohet në sigurimin e mbështetjes nga aksionari, institucionet qendrore dhe lokale, si dhe donatorët, përmes përgatitjes së projekteve konkrete, analizave të fizibilitetit dhe përcaktimit të prioriteteve investive, me qëllim zgjerimin dhe garantimin e qëndrueshmërisë së burimeve ujore.

2.2. Objektiva e dytë – “Zvogëlimi i humbjeve teknike dhe komerciale të ujit”

Humbjet e ujit paraqesin një sfidë kyçe për Kompaninë tonë, ndërsa viti 2026 konsiderohet periudhë kritike për arritjen e caktuar të zvogëlimit të ujit të pafaturuar (UPF) në nivelin e përcaktuar prej 48% nga Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit. Në këtë drejtim, Kompania do të vazhdojë të fokusohet në identifikimin e lidhjeve të paautorizuara, parandalimin e keqpërdorimeve, instalimin e ujëmatësve zonalë, si dhe zbatimin e masave të tjera të përcaktuara në përputhje me rregulloret e ARRUS-së. Ky angazhim është thelbësor për rritjen e efikasitetit dhe kontrollin e humbjeve të ujit, duke siguruar një menaxhim të qëndrueshëm të burimeve ujore dhe përmbushjen e standardeve rregullatore në shërbim të komunitetit.

2.3. Objektiva e tretë – “Arkëtimi i borxheve”

Arkëtimi i borxheve është një objektivë themelore për menaxhimin financiar. Numri i konsumatorëve debitorë ndaj Kompanisë është mbi 9,000 konsumatorë me një borxh total që tejkalon 6,000,000.00€. Aktivitetet për menaxhimin e këtyre borxheve do të vazhdojnë sipas një plani të veprimit, i cili përfshinë:

- **Telefonatat:** Kompania ka zhvilluar një fushatë intensive gjatë viteve 2023, 2024 dhe 2025, e cila do të vazhdojë edhe në vitin 2026, me qëllim njoftimin e konsumatorëve për obligimet e papaguara dhe arritjen e marrëveshjeve për pagesë. Ky aktivitet ka rezultuar i suksesshëm, pasi deri më tani janë lidhur marrëveshje me rreth 3,950 konsumatorë, në vlerë mbi 2,700,000.00 €, kryesisht për borxhe më të vjetra se një vit.
- **Vërejtjet:** Përfshijnë dërgimin e njoftimeve zyrtare për konsumatorët, me qëllim informimin mbi borxhet e papaguara dhe pasojat në rast të moskryerjes së pagesës në afat.
- **Shkyçjet:** Gjatë vitit 2026 do të shtohen tre ekipe të reja, secila e përbërë nga dy anëtarë, duke e çuar në gjashtë numrin total të ekipeve aktive. Këto ekipe do të ndahen në gjashtë zona të përcaktuara dhe secili ekip do të jetë përgjegjës për zonën e vet. Në rast mosreagimi ndaj vërejtjeve dhe mosshlyerjes së obligimeve, do të ndërmerren masa të shkyçjes nga shërbimi.
- **Procedurat përmbartimore:** Për sigurimin e arkëtimit të borxheve nga konsumatorët që nuk i përmbushin detyrimet, do të iniciohen procedurat përmbartimore. Qëllimi është arritja e marrëveshjeve për pagesë dhe përmirësimi i efikasitetit në menaxhimin e borxheve.

- **Paditë penale:** Në rastet kur masat e mëparshme nuk japin rezultat, do të ndiqen procedurat ligjore përmes gjykatave kompetente për rikuperimin e detyrimeve të papaguara.

2.4. Objektiva e katërt – “Rritja e shkallës së faturimit dhe arkëtimit”

Plani i arkëtimit për vitin 2026 parasheh arritjen e nivelit prej 96.39% të ujit të faturuar. Ky objektivi synohet të realizohet përmes mobilizimit të të gjitha kapaciteteve, veçanërisht të stafit të ekipeve për shkyçje të konsumatorëve që nuk i përmbushin obligimet për ujin e shpenzuar. Plani i arkëtimit do të përfshijë aplikimin e metodave të ndryshme organizative dhe operative për sigurimin e arkëtimit efikas të mjeteve.

Kompania do të zbatojë masa më rigorozë në rastet kur konsumatorët nuk kryejnë pagesat e tyre, me fokus të veçantë në kategoritë e konsumatorëve shtëpiak (amvisëri), bizneset e vogla dhe institucionet.

Në përpjekje për adresimin e sfidave në arkëtim, do të aplikohet një qasje e veçantë ndaj konsumatorëve shtëpiakë, me qëllim trajtimin e problemeve të mos-pagesës së ujit të shpenzuar përmes masave të mëposhtme:

- Përmirësimi i sistemeve të monitorimit dhe të pagesës së konsumit të ujit.
- Zbatimi i një politike më të rreptë për pagesën e borxheve të vonuara.
- Ndërmarrja e fushatave informuese ndaj konsumatorëve për rëndësinë e pagesës me kohë të ujit të konsumuar

Tabela 6. Planifikimi i performancës operative për vitin 2026

Treguesit Operativ	Plan Biznesi 2026
Prodhimi i ujit në m ³	9,019,000.00
Faturimi i ujit (%)	52.90
Arkëtimi i ujit (%)	96.39
Uji i pafaturuar (%)	47.10
Testet e dështuara (%)	-
Konsumatorë me Ujëmatës (%)	99.86
Numri i konsumatorëve të regjistruar	44,939
Numri i punëtorëve	180

3. TARIFAT E SHËRBIMIT

Kompania Rajonale e Ujësjetës "Hidromorava" Sh.A. zbaton tarifat e miratuara nga Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU). Bazuar në tarifat aktuale dhe duke marrë parasysh nivelin e prodhimit, shkallën e arkëtimit, si dhe nivelin e humbjeve komerciale dhe teknike, parashihet mbulimi i plotë i kostove operative të Kompanisë.

Tabela 7. Tarifat

		2024	2025	2026
Shtëpiak – tarifa fikse mujore	EUR/kons/muaj	1	1	1.25
Shtëpiak – volumetrike	EUR/m ³	0.35	0.39	0.5463
Komercial – industrial-tarifa fikse mujore	EUR/kons/muaj	2	2	2
Komercial – industrial-volumetrike	EUR/m ³	0.52	0.55	0.7101
Institucional – tarifa fikse mujore	EUR/kons/muaj	2	2	2
Institucional – volumetrike	EUR/m ³	0.52	0.55	0.7101
Ujërat e ndotura (vëllimi i ujit të konsumuar)				
Shtëpiak	EUR/m ³	0.08	0.12	0.1463
Komercial – industrial	EUR/m ³	0.17	0.27	0.3218
Institucional	EUR/ m ³	0.17	0.27	0.3218
Tarifat kumulative				
Shtëpiak (ujë dhe ujëra të ndotura)	EUR/ m ³	0.43	0.51	0.6926
Jo – shtëpiak (ujë dhe ujëra të ndotura)	EUR/ m ³	0.69	0.82	1.0319

4. SHËRBIMET PËR KONSUMATORË

Numri i konsumatorëve aktivë deri në shtator të vitit 2025 ka arritur në 42,186, duke shënuar një rritje prej 3,045 konsumatorësh krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak. Kjo rritje pritet të vazhdojë në mënyrë të qëndrueshme edhe deri në fund të vitit 2025, ku parashihet që numri i konsumatorëve aktivë të arrijë në 42,546. Kjo rritje do të jetë rezultat i zgjerimit të zonës së shërbimit dhe përfshirjes së konsumatorëve të rinj në sistem.

Gjatë vitit 2026 synojmë të rrisim më tej numrin e konsumatorëve, duke paraparë që deri në fund të vitit të arrijmë në 44,939 konsumatorë aktivë. Në këtë drejtim, pritet që identifikimi i konsumatorëve ilegalë të bëhet më i lehtë dhe më efikas përmes funksionalizimit të plotë të Sistemit të Informacionit Gjeografik (GIS). Përdorimi i GIS-it nga lexuesit e ujëmatësve dhe personeli i terrenit do të mundësojë identifikimin e të gjithë konsumatorëve që shfrytëzojnë shërbimet e ujësjellësit, si dhe do të lehtësojë inspektimin dhe evidentimin e kyçjeve të paautorizuara në rrjet. Gjithashtu, planifikohet inspektimi i konsumatorëve me konsum zero, me qëllim të verifikimit të gjendjes faktike dhe identifikimit të arsyeve që kanë çuar në mungesën e konsumit të regjistruar.

Synimi kryesor i Ndërmarrjes gjatë periudhës 2026–2028 është rritja e cilësisë së shërbimeve ndaj konsumatorëve, duke filluar nga leximi i saktë i ujëmatësve dhe shpërndarja e faturave, funksionalizimi i Call Center-it, si dhe ofrimi i shërbimeve korrekte, efikase dhe transparente për konsumatorët.

Në kuadër të procesit të leximit të ujëmatësve, në bashkëpunim me Zyrën e GIS-it është testuar një aplikacion pilot për dërgimin e fotografive të ujëmatësve nga terreni, së bashku me lokacionin dhe shënime shtesë. Rezultatet e këtij projekti kanë qenë shumë pozitive, pasi është arritur mbulimi pothuajse i të gjithë zonës së shërbimit dhe pranimi i të dhënave reale të ujëmatësve. Kjo ka reduktuar mundësitë e manipulimit në terren dhe ka rritur nivelin e transparencës në proces. Edhe pse aplikacioni kërkon zhvillim të mëtejshëm, si projekt pilot ai ka ofruar bazën dhe përvojën e nevojshme për përmirësimin e performancës operative dhe reduktimin e humbjeve komerciale.

Gjatë vitit 2026 parashihet zhvillimi i një aplikacioni të avancuar për lexim nga distanca, i cili do të përfshijë funksione për printimin dhe gjenerimin e faturave në kohë reale, si dhe mundësi funksionimi në regjim offline. Po ashtu, planifikohet zhvillimi i aplikacioneve për pagesa online të faturave, raportim të defekteve, komunikim me Call Center-in dhe ofrim të shërbimeve të tjera digjitale, të cilat do t'u mundësojnë konsumatorëve realizimin e të gjitha shërbimeve pa qenë e nevojshme paraqitja fizike në zyrat e kompanisë.

Gjithashtu, gjatë vitit 2026 planifikohet shpërndarja e kontratave të secili konsumator, me qëllim të formalizimit të plotë të marrëdhënieve kontraktuale dhe forcimit të bashkëpunimit ndërmjet kompanisë dhe konsumatorëve.

Objektivat kryesorë të Divizionit për Konsumatorë për periudhën trevjeçare 2026–2028 janë:

- Leximi i saktë i të gjithë ujëmatësve në baza të rregullta, në përputhje me rregulloret e ARRU-së;
- Rritja e numrit të konsumatorëve përmes identifikimit dhe legalizimit të lidhjeve ilegale;

- Rritja e numrit të kontratave të shërbimit me konsumatorët;
- Ulja e numrit të ankesave komerciale;
- Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së shërbimeve ndaj konsumatorëve.

Gjatë procesit të shkyçjeve do të respektohen në mënyrë rigoroze dispozitat e rregulloreve të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU). Për realizimin e tyre, sipas nevojës, Ndërmarrja do të bashkëpunojë me Policinë e Kosovës – Rajoni i Gjilanit, për të siguruar mbështetjen e nevojshme në rastet kur paraqiten pengesa ose rezistencë gjatë ekzekutimit të procedurave. Konsumatorët që nuk lejojnë realizimin e shkyçjeve teknike do të procedohen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe përmes rrugëve ligjore.

Kompania mbetet e përkushtuar në përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve ndaj konsumatorëve dhe në rritjen e transparencës dhe bashkëpunimit me të gjithë akterët e sektorit të ujit. Në këtë kuadër, shërbimi për marrëdhënie me konsumatorët do të zhvillohet më tej përmes regjistrimit dhe raportimit elektronik të ankesave, monitorimit të afateve për trajtimin e tyre dhe shqyrtimit efikas, në përputhje me standardet e përcaktuara kohore dhe kërkesat rregullatore.

4.1. Të ardhurat nga arkëtimi dhe shpenzimet operative

Arkëtimi i të ardhurave nga shërbimet e ujit për vitin 2026 planifikohet të arrijë në 3,846,661 €, që përfaqëson 96.39% të vlerës së ujit të faturuar. Gjithashtu, planifikohet arkëtimi i 253,003.00 € nga borxhet e vjetra nëpërmjet marrëveshjeve të lidhura me konsumatorët. Në total, niveli i përgjithshëm i arkëtimit parashihet të arrijë në 96.52%.

Parashikohet rritje e të hyrave, duke përfshirë edhe arkëtimin e borxheve të vjetra. Në këtë drejtim, ndikim pozitiv do të ketë përmirësimi i procesit të leximit të ujëmatësve dhe sigurimi i leximeve sa më të sakta, me qëllim që konsumatorët të pajisen me fatura që pasqyrojnë në mënyrë reale konsumin e tyre mujor.

Gjatë këtij procesi do të identifikohen dhe eliminohen rastet e lidhjeve të dyfishta. Në rastet kur konstatohet manipulim me ujëmatës apo ndërhyrje të paautorizuara në sistemin matës, konsumatorët përkatës do të procedohen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe do të mbajnë përgjegjësi sipas dispozitave të Kodit Penal.

Në përmirësimin e nivelit të arkëtimit do të ndikojë gjithashtu fuqizimi dhe zgjerimi i ekipeve të shkyçjes, të cilat do të ndërmarrin veprime konkrete ndaj konsumatorëve me obligime të papaguara. Po ashtu, ndikim pozitiv pritet të ketë edhe rritja e mundësive për realizimin e pagesave, si në arkat e Kompanisë ashtu edhe në institucionet mikrofinanciare, duke ua lehtësuar konsumatorëve kryerjen e obligimeve të tyre financiare. Këto pika pagese janë të shpërndara në lokacione të ndryshme të qytetit dhe përfshijnë gjithashtu pagesat e realizuara përmes llogarive bankare, duke kontribuar në rritjen e efikasitetit të arkëtimit dhe përmirësimin e shërbimeve ndaj konsumatorëve.

Tabela 8. Parashikimi i arkëtimit

		2026	2027	2028
Shtëpiak	% e arkëtimit	96.00%	96.00%	96.00%
Komercial-industrial	% e arkëtimit	100.00%	100.00%	100.00%


Institucional	% e arkëtimit	100.00%	100.00%	100.00%
Norma e përgjithshme	% e arkëtimit	96.39%	96.24%	96.10%

s

Tabela 9. Shpenzimet sipas kategorive për vitet 2024, 2025 dhe 2026

Shpenzimet operative	2024	2025	2026
Ngarkesa për shërbime ndaj ARRU, MMPH, SHUKOS	39,418	36,261.00	48,196.00
Shpenzimet e materialit dhe materieve të konsumueshme	76,692	94,554.00	95,600.00
Shpenzimet e shërbimeve të kontraktuara	39,726	60,531.00	63,200.00
Shpenzimet e energjisë	296,058	485,000.00	679,500.00
Shpenzimet e mirëmbajtjes dhe riparimit	56,350	48,295.00	42,372.00
Shpenzimet e derivateve	44,717	33,609.00	40,000.00
Shpenzimet e personelit	1,519,936	1,652,343.00	2,097,608.00
Shpenzimet tjera direkte dhe indirekte	11,357	58,391.00	35,500.00
Total	2,084,254	2,468,984.00	3,101,976.00

Grafiku 1. Shpenzimet sipas viteve



Nga grafiku i mësipërm vërehet një trend i vazhdueshëm i rritjes së shpenzimeve gjatë secilit vit të periudhës planifikuese. Kjo rritje lidhet drejtpërdrejt me zgjerimin e vazhdueshëm të zonës së shërbimit dhe marrjen në menaxhim të zonave të reja rurale, si rezultat i realizimit të projekteve të financuara nga donatorët dhe Komuna e Gjilanit.

Përfshirja e këtyre zonave në sistemin e menaxhimit të Kompanisë sjell rritje të shpenzimeve operative, veçanërisht të atyre që ndikojnë drejtpërdrejt në koston e prodhimit dhe distribuimit të ujit. Një pjesë e konsiderueshme e sistemeve të reja të furnizimit funksionojnë me pompim, gjë që gjeneron kosto më të larta të energjisë elektrike, mirëmbajtjes dhe operimit. Përveç kësaj, zgjerimi i zonës së shërbimit ndikon edhe në

rritjen e shpenzimeve të tjera operative, duke reflektuar nevojën për resurse shtesë njerëzore, teknike dhe logjistike për ofrimin e shërbimeve cilësore në të gjithë territorin e mbuluar nga Kompania.

5. PROGRAMET E REKRUTIMIT – PLOTËSIM I POZITAVE TË REJA

- Dy (2) Teknik për nderprerje të shërbimeve përshkak të borxheve;
- Dy (2) Teknik për kontroll dhe shkycje të lidhjeve të paautorizuara;
- Dy (2) Punëtor fizik për divizionin e ujërave të ndotura;
- Një (1) Shofer për eskavator/cisterna;
- Një (1) Zyrtar për Media/Zëdhënës i Ndërmarrjes.

6. INVESTIMET KAPITALE

6.1. Blerja e paisjeve fazonerike²

Tabela 10. Blerja e paisjeve fazonerike (Rishikim i vlerës)

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Viti Investimit
Investimi në blerjen e pajisjeve fazonerike për mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit	180,000.00 €	Vetanake	2026-2028
Totali:	180,000.00 €		

6.2. Furnizimi dhe instalimi i manometrave me GPRS³

Tabela 11. Furnizimi dhe Instalimi i Manometrave me GPRS (Rishikim i vlerës)

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Viti Investimit
Furnizimi dhe instalimi i manometrave me GPRS për gjithë zonën e shërbimit	130,000.00 €	Vetanake	2026-2027
Totali:	130,000.00 €		

² Projekti në fjalë është pjesë e Planit të Biznesit 2026–2028, respektivisht Tabelës 32. Duke qenë se kontrata aktuale është në përfundim, është e nevojshme dhe urgjente që nga shuma e paraparë prej 300,000 € në vitin 2028 të ndahen 180,000 € për këtë periudhë, me qëllim të inicimit të procedurës për kontratë komizë me kohëzgjatje prej 36 muajsh.

³ Projekti në fjalë është pjesë e Planit të Biznesit 2026–2028, respektivisht Tabelës 40. Projekti është paraparë fillimisht në vlerën prej 20,000 €, ndërsa pas aprovimit të rritjes së vlerës në 30,000 € nga menaxhmenti i Kompanisë, edhe pas dy proceseve të tenderimit nuk ka pasur operatorë ekonomikë ofertues. Propozohet rritja e vlerës në 130,000 €, me ç'rast projekti do të shtrihet edhe në zona të tjera urbane dhe rurale. Ky projekt është rezultat i gjetjeve dhe rekomandimeve të raportit të ARRU-së. Kontrata parashihet të ketë kohëzgjatje prej 12 muajsh.

6.3. Investime në zvogëlimin e humbjeve të ujit⁴

Tabela 12. Investime në zvogëlimin e humbjeve të ujit (Rishikim i vlerës dhe ndarje nga projekte në kuadër të kapitullit 10.28)

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Viti Investimit
Zëvendësimi i ujëmatësve individual sipas vjetërsisë në Gjilan, Viti dhe Kamenicë.	100,000.00 €	Vetanake	2026 – 2027
Totali:	100,000.00 €		

6.4. Modifikimet ne sistemin Scada dhe ndërrimi i pajisjeve në ITU Velekincë

Tabela 13. Modifikimet ne sistemin Scada dhe ndërrimi i pajisjeve në ITU Velekincë

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Viti Investimit
Modifikimet ne sistemin Scada dhe ndërrimi i pajisjeve në ITU Velekincë	200,000.00 €	Vetanake	2026 – 2027
Totali:	200,000.00 €		

6.5. Furnizimi me makineri për divizionin e ujërave të ndotura

Tabela 14. Furnizimi me makineri për divizionin e ujërave të ndotura.

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Viti Investimit
Kombi për deblokim	49,000.00 €	Vetanake	2026 – 2027
Gërshër për bartje të pusetave	1,400.00 €	Vetanake	
Totali:	50,400.00 €		

⁴ Projekti në fjalë është pjesë e Planit të Biznesit 2026–2028, respektivisht Tabelës 39. Duke marrë parasysh rëndësinë e projektit dhe vjetërsinë e ujëmatësve, ku një numër i konsiderueshëm i tyre janë mbi 10 vjet të vjetër, është vendosur që për këtë periudhë të ndahen 100,000 € nga vlera e përgjithshme prej 200,000 € e paraparë në Planin e Biznesit. Pjesa e mbetur e mjeteve do të shfrytëzohet për iniciimin e fazës së dytë të projektit pas përfundimit të fazës së parë. Kontrata parashihet të ketë kohëzgjatje prej 12 muajsh.

7. REKAPITULIMI

Tabela 15. Rekapitullimi i projekteve

	Përshkrimi	Vlera (€)
1.	Blerja e paisjeve fazonerike	180,000.00€
2.	Furnizimi dhe instalimi i manometrave me GPRS	130,000.00€
3.	Investime në zvogëlimin e humbjeve të ujit	100,000.00€
4.	Modifikimet ne sistemin Scada dhe ndërrimi i pajisjeve në ITU Velekincë	200,000.00€
5.	Furznizimi me makineri për divizionin e ujërave të ndotura	50,400.00€
	Totali:	660,400.00 €

Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve


Z. Habil Zeqiri

